



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

---



**R R E G U L L O R E**  
**E P U N Ě S E K U V E N D I T K O M U N A L**  
**T Ě R A H O V E C I T**

**Rahovec, 15 maj 2009**

Në bazë të dispozitës ligjore të nenit 11 dhe nenit 12, alineja 12.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, si dhe në mbështetje të nenit 2 të Statutit të Komunës 01 Nr. 569 të datës 29.09.2008, Kuvendi i Komunës së Rahoveci, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 15 maj 2009, miraton këtë:

## **R R E G U L L O R E** **PËR PUNËN E KUVENDIT KOMUNAL TË RAHOVECIT**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

Me këtë rregullore të punës (në tekstin e mëtejme: rregullore), rregullohet puna e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, e komiteteve punuese, organizimi i brendshëm, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit.

#### **Neni 2**

Anëtarët fitojnë të drejtat dhe detyrimet në kuvend ditën e verifikimit të mandatit dhe pas dhënies së betimit. Çdo anëtar që merr pjesë në mbledhje do t'i shënohet emri i tij/saje, në listën për personat prezent të dedikuar për këtë qëllim.

#### **Neni 3**

Kuvendi i komunës dhe komitetet e tij i trajtojnë çështjet të cilat janë nën kompetencën e komunës.

#### **Neni 4**

Puna e kuvendit dhe organeve të tij është publike përveç nëse kuvendi vendos ndryshe.

### **II. KONSTITUIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS**

#### **a) Seanca konstituive**

#### **Neni 5**

1. Kuvendi e mban mbledhjen e parë konstituive brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

2. Mbledhjen e parë konstituive të kuvendit e thërret kryetari i komunës, ndërsa e kryeson anëtari më i moshuar i cili është në listën e anëtarëve të zgjedhur, të cilin në punë e ndihmojnë dy anëtarë më të rinj.

3. Nëse kryetari i komunës nuk e thërret mbledhjen sipas obligimit, mbledhja inaugurose e kuvendit të komunës mund të thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i kuvendit të komunës brenda 15 ditësh nga data kur kryetari është dashur të thirrë mbledhjen inaugurose të kuvendit të komunës.

4. Nëse anëtari më i vjetër i kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij, mbledhja inaugurose e kuvendit të komunës mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të kuvendit të komunës.

5. Rendi i ditës i mbledhjes konstituive përmban:

- (1) verifikimin e moshës së anëtarit më të vjetër dhe dy anëtarëve më të rinj të kuvendit;
- (2) ngritjen e komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit;
- (3) raportin e komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit;

- (4) dhënien dhe nënshkrimin e betimit të anëtarëve të kuvendit;
- (5) dhënien dhe nënshkrimin e betimit të kryetarit dhe nënkryetarit të komunës;
- (6) ngritjen e komisionit për mbikëqyrjen e votimit për zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit per komunitete të kuvendit;
- (7) procesin për zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit per komunitete të kuvendit;
- (8) raportin e komisionit për rezultatet e votimit të zgjedhjes së kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit per komunitete të kuvendit; dhe
- (9) dhënien e nënshkrimin e betimit të kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit per komunitete të kuvendit.

#### **b) Verifikimi i mandateve**

##### **Neni 6**

1. Verifikohet lista e anëtarëve të kuvendit komunal të zgjedhur në zgjedhjet e lira dhe demokratike, ku verifikimin e bën kryesuesi i mbledhjes konstituive së bashku me nga një anëtar të partive politike që kanë të drejtë të formojnë grup e keshilltareve.
2. Mandati i çdo anëtari të kuvendit verifikohet duke iu shënuar emri, mbiemri, subjekti politik nga i cili vjen, si dhe nënshkrimi i tij personal.

#### **c) Betimi i anëtarëve të kuvendit**

##### **Neni 7**

Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e kuvendit e japin betimin dhe fitojnë të drejtat dhe detyrimet në kuvend. Teksti i betimit të anëtarëve të kuvendit është: **“Beto hem se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtrojë autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit Komunal të Rahovecit me nder, me besnikëri, pa anim dhe me ndërgjegje sipas ligjit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë”**.

### **III. KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL**

#### **a) Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit per kominitete**

##### **Neni 8**

**Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi per komunitete** zgjedhen me votim të fshehtë dhe atë:

1. Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi per komunitete i Kuvendit të Komunës zgjedhen nga radhët e anëtarëve për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit.
2. Për t’u zgjedhur në votimin e parë kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.
3. Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të shumicës së thjeshtë prezentë në mbledhje do të zgjidhet kryesues i Kuvendit të Komunës, e njëjta vlen edhe për zëvendëskryesuesin per komunitete.

#### **b) Betimi i Kryesuesit – Zëvendëskryesuesit per komunitete**

##### **Neni 9**

Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi japin betimin dhe e nënshkruajnë deklaratën, sipas tekstit: **“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia**

**në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit në mënyrë që të sigurohen kushtet për një jetë të qetë për të gjithë qytetarët”.**

#### **Neni 10**

##### **c) Detyrat e Kryesuesit të Kuvendit:**

##### **1. Kryesuesi i kuvendit:**

- (1) Thërret mbledhjet e kuvendit,
- (2) Kryeson dhe siguron mbarëvajtjen e punimeve të mbledhjes,
- (3) Deklaron hapjen dhe mbylljen e mbledhjeve të kuvendit,
- (4) Jep të drejtën e fjalës,
- (5) Drejton diskutimet dhe njofton mbylljen e diskutimeve,
- (6) Cakton radhën e votimeve, sqaron domethënien e votimit dhe njofton për rezultatin e votimit,
- (7) Kujdeset për mbajtjen e rregullit gjatë zhvillimit të mbledhjeve,
- (8) Jep leje në çdo kohë për kërkesat e anëtarëve të kuvendit që kanë të bëjnë me zbatimin e rregullores në rast shkeljeje,
- (9) Merr masa disiplinore të parashikuara me këtë rregullore,
- (10) Pezullon punimet e mbledhjes kur është i pamundur zhvillimi normal i tyre,
- (11) Shpall vendimet e kuvendit,
- (12) Organizon mbledhjet e përbashkëta me kryetarët dhe anëtarët e komiteteve të kuvendit,

**2.** Mbledhjet e kuvendit nëse nuk thirren nga kryesuesi apo zëvendeskryesuesi mund të thirren nga 1/3 e anëtarëve të kuvendit të komunës ndërsa kryesohen nga anëtari më i vjetër i kuvendit.

##### **d) Mbledhjet e jashtëzakonshme**

#### **Neni 11**

- 1.** Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës apo me kërkesë të kryetarit të komunës.
- 2.** E drejta për të caktuar një mbledhje të jashtëzakonshme gjithashtu përfshin edhe të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.
- 3.** Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
- 4.** Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim siç kërkohet me këtë rregullore.
- 5.** Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për mbledhjet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

#### **Neni 12**

**1.** Në mungesë të kryesuesit zëvendësi i tij mund të thërret dhe kryesojë mbledhjen, nëse edhe zëvendësi i tij mungon atëherë mbledhjen e thërret kryetari i komunës, ndërsa kryesimi i mbledhjes bëhet nga anëtari më i moshuar në mbledhje.

**2.** Kryesuesi i mbledhjes është i obliguar që t’iu dërgojë thirrje me shkrim për pjesëmarrje në mbledhje çdo anëtari të kuvendit së bashku me rendin e ditës i cili përcakton çështjet për të cilat diskutohet në mbledhje.

#### **Neni 13**

Kuvendin e përfaqëson kryesuesi i kuvendit, e në mungesë të tij zëvendëskryesuesi.

**Neni 14**

1. Kuvendi Komunal dhe komitetet e tij i mbajnë mbledhjet e tyre në termine të rregullta ashtu sikur se është paraparë me programin e punës së kuvendit.
2. Kuvendi duhet të i mbajë së paku 10 (dhjetë), mbledhje brenda vitit kalendarik.
3. Sipas nevojës, për shqyrtimin e çështjeve të natyrës së ngutshme. Kuvendi mban mbledhje urgjente- të jashtëzakonshme.

**e) Shkarkimi i kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit per komunitete****Neni 15**

Kryesuesi dhe zëvendëskryesi per komunitete mund të shkarkohen nga detyra vetëm me votat e shumicës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit komunal.

**Neni 16**

Nëse lirohet vendi kryesuesit ose zëvendëskryesuesit per komunitete, kuvendi komunal e zgjedh kryesuesin ose zëvendëskryesuesin e ri jo më larg se tridhjetë ditë pas konstatimit të vendit të lirë.

**IV. KOMITETET DHE KOMISIONET****a) Komitetet obligative****Neni 17**

1. Për kryerjen e funksioneve të tij kuvendi formon 2 (dy) komitete të obliguara dhe atë:
  - Komiteti për Politikë dhe Financa dhe,
  - Komiteti për Komunitete.
2. Përveç komiteteve të obliguara nga kuvendi sipas nevojës, mund të formojë edhe komitete të tjera, për fusha të caktuara.
3. Në komitetet e kuvendit sipas parimit marrin pjesë anëtarët e të gjitha partive sipas proporcionit që zënë ato në kuvend. Nuk mund të jenë anëtarë të komiteteve të kuvendit anëtarët e organit konsultativ-drejtorët.

**Neni 18**

Anëtarët e komiteteve të kuvendit zgjedhen me propozimin e kryesuesit të kuvendit me vota të hapura, në bazë të listave të kandidatëve të hartuara sipas marrëveshjes midis kryetarëve të grupeve të përfaqësuara në kuvendin komunal.

**Neni 19**

Komiteti e zgjedh kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin. Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit bëhet duke pasur parasysh përfaqësimin e grupeve të përfaqësuara sipas proporcioneve që zënë në kuvend.

**Neni 20**

Kryesuesi i komitetit kryen këto detyra:

- (1) Organizon mbledhjen dhe punën e komitetit,
- (2) Mbanë lidhje dhe bashkërendon veprimtarinë e komitetit me komitetet tjera të kuvendit.

**Neni 21**

Kuvendi komunal me vendim të posaçëm formon dhe përcakton kohëzgjatjen dhe detyrat e komitetit të formuar.

## V. PUNIMET E KUVENDIT DHE TË KOMITETEVE

### 1. Punimet e Kuvendit

#### Neni 22

Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit thirren nga ana e kryesuesit të kuvendit ose zëvendëskryesuesit për komunitete.

#### Neni 23

1. Mbledhjet e kuvendit mbahen kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të kuvendit.
2. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e kuvendit dhe komiteteve të tij përbëhet nga shumica e anëtarëve të kuvendit të komunës apo komitetit (50% +1).

#### Neni 24

Mbledhjet e kuvendit janë publike, me përjashtim të rasteve kur kuvendi vendosë ndryshe.

#### Neni 25

1. Kuvendi mund të vendos që zhvillimin e mbledhjeve për raste të veçanta ta mbaj me dyer të mbyllura.
2. Kur vendoset që mbledhja të zhvillohet me dyer të mbyllura kryesuesi i mbledhjes u kërkon personave të ftuar, personave nga publiku, dhe mediave që të largohen nga salla e mbledhjes.

#### Neni 26

1. Personat që nuk janë anëtarë ose drejtorë të drejtorive të kuvendit komunal mund të asistojnë në mbledhjet e kuvendit duke i zënë vendet e caktuara për ta.
2. Personat e ftuar dhe personat nga publiku që asistojnë në mbledhjet e kuvendit janë të detyruar të respektojnë rregullat e punës së kuvendit, e në rast shkeljeje kryesuesi i mbledhjes mund të urdhërojë largimin e tyre nga salla.

#### Neni 27

Në mbledhjet e kuvendit mbahen procesverbale dhe bëhet audioinçizime.

Çdo anëtar i kuvendit dhe çdo person tjetër i interesuar ka të drejtë të njihet me këto procesverbale.

#### Neni 28

Procesverbalet, diskutimet dhe regjistrimet radiotelevizive të mbledhjeve me dyer të mbyllura administrohen sipas rregullave të ruajtjes së sekretit shtetëror, kurse vendimet që merren shpallen publikisht.

#### Neni 29

1. Kalendari i mbledhjeve të kuvendit përcakton në mënyrë të detajuar, datën, muajin, vitin, vendin dhe orën se kur mbahen mbledhjet e kuvendit komunal.
2. Kalendari dhe programi i zhvillimeve të punës së kuvendit të miratuar nga kuvendi iu dorëzohet të gjithë anëtarëve të kuvendit, si dhe u vihet në dispozicion mediave.

#### Neni 30

Në fillim të çdo mbledhje kryesuesi e bën të njohur rendin e ditës.

**Neni 31****Rendi i punës së mbledhjes zakonisht do të jetë ky:**

- (1) Kërkim falje për mospjesëmarrje në mbledhje,
- (2) Miratimi i procesverballi të mbledhjes së fundit,
- (3) Miratimi i rendit të punës,
- (4) Raportet dhe rekomandimet e marra nga komitetet dhe çfarëdo çështje tjera që lindin si rezultat i raportit,
- (5) Raportet dhe rekomandimet e pranuar nga kryetari i komunës,
- (6) Çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e komunës dhe të shkruara nga anëtarët, sipas rendit se si ato janë pranuar,
- (7) Vendosja për pyetjet e anëtarëve të kuvendit dhe,
- (8) Të ndryshme.

**Neni 32**

1. Kuvendi nuk mund të diskutojë e të vendosë për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Për të diskutuar ose për të vendosur për çështje që nuk janë në rendin e ditës duhet të vendoset me shumicën e votave pas propozimit që bëhet në fillim të mbledhjes.

**Neni 33**

Gjatë tërë kohëzgjatjes së mbledhjes kryesuesi duhet ta respektojë parimin që të gjithë anëtarët pjesëmarrës dhe me të drejtë diskutimi të gëzojnë të drejtën e barabartë për diskutim në mbledhje.

**Neni 34**

Mbledhjen e hap kryesuesi i mbledhjes. Diskutimet fillojnë pasi kryesuesi i mbledhjes njofton për hapjen e mbledhjes. Asnjë anëtar nuk mund të diskutojë pa ia dhënë fjalën kryesuesi i mbledhjes.

**Parashtrimi i pyetjeve për kryetarin e komunës/drejtorët****Neni 35**

1. Secili anëtar i kuvendit ka të drejtë të parashtojë pyetje lidhur me punën e një drejtorie përkatëse.
2. Në seancat e kuvendit për përgjigjet e dhëna në pyetjet e bëra parashihet koha që:
  - (1) kryetari/drejtori i drejtorisë përkatëse t'iu përgjigjet pyetjeve me gojë ose me shkrim më së voni deri në seancën e radhës.
  - (2) Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet t'i dorëzohen të paktën 5 ditë pune por jo më shumë se 10 ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to. Asnjë anëtar i kuvendit nuk mund t'i parashtojë kryetarit/drejtorit më shumë se 2 pyetje. Pyetjet duhet të jenë lidhur me përgjegjësitë e zyrtarit në fjalë.
  - (3) Pyetjet që parashtrihen nga anëtarët e kuvendit gjatë seancës duhet të paraqiten me shkrim dhe për të njëjtat përgjigjja me shkrim do të merret në seancën e radhës.
  - (4) Kryesuesi i kuvendit do të lejojë anëtarin e kuvendit që pas përgjigjes së zyrtarit të bëjë menjëherë edhe pyetje shtesë. Parashtrimi i pyetjes, dhënia e përgjigjes, parashtrimi i pyetjes shtesë dhe përgjigja në të nuk mund të zgjasin më tepër se 5 minuta.

### **Çështjet e ngutshme**

#### **Neni 36**

Në të gjitha seancat e kuvendit çdo grup i anëtarëve të kuvendit ose anëtar që paraprakisht ka marrë lejen e kryesuesit të kuvendit mund të propozojë që kuvendi menjëherë të merr parasysh një çështje të ngutshme me interes të veçantë publik, e cila është paraqitur në kohën midis dy mbledhjeve të kuvendit. Nëse kryesuesi së bashku me anëtarët konsideron se çështja meriton vëmendjen e menjëhershme të kuvendit, ai do të lejojë grupin ose anëtarin në fjalë që të arsyetojë propozimin e tij në kuvend e pastaj do të vë në votim atë çështje.

### **Rregullat e Debatimit**

#### **Neni 37**

Kryesuesi i mbledhjes në fillim njofton për shkresat dhe parashtrirat e arritura në kuvend, por nuk njofton edhe për parashtrirat anonime si dhe për ato që kanë përmbajtje të paligjshme.

#### **Neni 38**

1 Nuk mund të diskutohet asnjë propozim , përpara se ai të shtrohet dhe të përkrahet nga kuvendi , gjegjësisht të aprovohet për rend pune.

2 Nëse propozimi pëson ndryshime, propozimi i dytë i aprovuar e zë vendin e të parit.

3. Fjala në kuvend kërkohet me ngritjen e dorës, sipas regjistrimit paraprak, nëpërmjet sistemit elektronik ose me kërkesën paraprake me shkrim.

4. Emrat e diskutuesve regjistrohen.

#### **Neni 39**

1. Kryesuesi i mbledhjes vendos për renditjen e atyre që kërkojnë fjalën. Pasi ta marrin fjalën anëtarët i drejtohen kryesuesit të kuvendit dhe duhet t'i përmbahen çështjeve aktuale të mbledhjeve.

2 Kryetarëve të grupeve të keshilltareve u ipet përparësi gjatë diskutimit.

3. Për renditjen e kryetarëve të grupeve që kanë kërkuar fjalën vendos kryesuesi.

#### **Neni 40**

1. Lejohet ndërrimi i radhës së diskutimeve me marrëveshjen e anëtarëve.

2. Anëtari i cili kur i jepet fjala nga drejtuesi i mbledhjes nuk është në sallë konsiderohet se ka heqë dorë nga diskutimi.

#### **Neni 41**

Kur një propozim është në shqyrtim, nuk lejohen propozime të tjera përveç:

- 1). ndryshime në propozim;
- 2). ndalim të parregullsive;
- 3). përjashtim të publikut;
- 4). kalim në pikën me radhë të rendit të ditës;
- 5). marrje të vendimit për propozimin;
- 6). shtyrje të diskutimit për mbledhjen e ardhshme;
- 7). ndërprerje të mbledhjes.

#### **Neni 42**

Kryesuesi nuk do të lejojë zbatimin e pikës 4 dhe 5 të nenit paraprak, deri sa ta marrin fjalën të gjithë ata që dëshirojnë.



**Neni 43**

- 1 Kur një anëtar e ka fjalën, të tjerët qëndrojnë ulur.
2. Për propozimin e dhënë mund të merret përgjigje menjëherë para se t'i nënshtrohen votimit.
3. Kur lista e diskutuesve ka përfunduar ose kur nuk e kërkon fjalën asnjëri nga anëtarët, kryesuesi i mbledhjes e përfundon mbledhjen.

**Neni 44**

1. Çdo diskutues me përjashtim të rasteve kur me këtë rregullore parashikohet ndryshe ka të drejtë që të flasë për një kohë jo më tepër se 3 (tre) minuta, dhe jo më shumë se një herë për thelbin e të njëjtës çështje.
2. Kryetarëve të grupeve të anëtarëve të kuvendit ju lejohet diskutimi deri në 6 (gjashtë) minuta, dhe jo me shume se nje here per thelbin e te njejtës ceshtje.
3. Kryesuesi duhet t'i përmbahet parimit të barabarësisë së anëtarëve dhe duhet që të gjithëve t'iu mundësojë pjesëmarrje të barabartë në diskutim. Nëse në diskutim paraprak përmendet me emër ndonjë anëtar i kuvendit, ai ka të drejtë të replikojë, por jo më gjatë se 2 (dy) minuta.
3. Qytetarët që marrin pjesë në tubime publike ose në mbledhje me propozime , do t'u lejohet diskutimi më së shumti 3 (tre) minuta, por nuk i'u lejohet votimi.

**Neni 45**

Kryesuesi ka të drejtë që të zgjasë kohën e diskutimit për një ose dy diskutues të cilit do grup të anëtarëve të kuvendit, kur vlerëson se këtë e kërkon rëndësia e çështjes që diskutohet.

**Neni 46**

1. Kur diskutuesi e kalon kohën e caktuar ose del jashtë temës që diskutohet kryesuesi i mbledhjes ia tërheqë vërejtjen që t'i përmbahet diskutimit sipas pikës të rendit të ditës.
- 2 Nëse diskutuesi vazhdon përsëri dhe është jashtë pikës së rendit të ditës i tërhiqet vërejtja edhe herën e dytë. Nëse nuk vepron sipas vërejtjes së kryesuesit atëherë atij i merret e drejta e fjalës.

**Neni 47**

1. Anëtari i kuvendit ka të drejtën e replikës. Replika është kundërshtim i shkurtër për thelbin e një diskutimi të përfunduar. Replika bëhet menjëherë pas diskutimit dhe nuk mund të zgjasë më tepër se 2 (dy) minuta.
2. Për të njëjtin diskutim nuk mund të bëhen më shumë se nje replike. Pas replikes vetëm anëtari që ka diskutuar ka të drejtën e përgjigjjes deri në dy minuta.
3. Anëtarëve të tjera nuk u lejohet të bëjnë replika ndaj replikës.

**Neni 48**

Në rast të diskutimit për çështje të rregullores, kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë kur e kërkon rëndësia e çështjes t'ia jep fjalën një anëtar i prej secilit grup si dhe të zgjasë kohën e parashikuar për ndërhyrje.

**Neni 49**

Kur gjatë zhvillimit të mbledhjes bëhet zhurmë e madhe në sallë, shkelje të rregullave që pengojnë zhvillimin e mëtutjeshme të punës së kuvendit ose për arsye tjera të rëndësishme, kryesuesi i mbledhjes mund të ndërpresë mbledhjen për një kohë të caktuar.

**Neni 50**

Kur vlerësohet nga kryesuesi i mbledhjes ose me kërkesën e një grupi të anëtarëve, kryesuesi mund të ndërpresë mbledhjen për një kohë të caktuar, por jo më tepër se 60 minuta dhe vetëm një herë për të njëjtën çështje.

**2. Punimet e komiteteve****Neni 51**

Mbledhjet e komiteteve thirren nga kryesuesit e tyre si dhe me kërkesën e jo më pak se 1/3 të anëtarëve të komitetit, ose me kërkesën e kryesuesit të kuvendit duke përcaktuar në kërkesën çështjet që do të diskutohen në atë mbledhje.

**Neni 52**

1. Mbledhjet e komitetit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më tepër se gjysma (50%+1) e anëtarëve të tyre. Vendimet merren me shumicën relative të votave dhe me votim të hapur.
2. Për mirëvajtjen e punëve të komiteteve duhet të udhëhiqet procesverbali i mbledhjes.

**Neni 53**

1. Mbledhjet e komiteteve janë publike, me përjashtim të rasteve kur komiteti merr vendim që ato të mbahen të mbyllura.
2. Personat që marrin pjesë në mbledhje të mbyllura të komiteteve janë të detyruar që të respektojnë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror.

**Neni 54**

Në mbledhjet e komiteteve mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe personat që nuk janë anëtarë të komiteteve si dhe persona të tjerë të ftuar nga ana e komitetit.

**Neni 55**

1. Komitetet, kur e shohin të nevojshme mund të mbajnë edhe mbledhje të përbashkëta.
2. Mbledhjet e përbashkëta i kryeson njëri nga kryesuesit e komiteteve i cili caktohet me marrëveshjen ndërmjet tyre, e nëse kjo nuk arrihet, atëherë mbledhjen e kryeson kryesuesi i atij komiteti që ka më tepër lidhje me çështjen e cila shqyrtohet.

**Neni 56**

1. Në mbledhjet e përbashkëta të komiteteve vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Kur qëndrimet janë të ndryshme, secili nga komitetet merr vendim të veçantë dhe paraqet raportin e tij me shkrim në mbledhjen e kuvendit.

**Neni 57**

1. Kur një komitet vlereson se një projekt që i është dërguar për shqyrtim duhet të japë mendim edhe një komitet tjetër, atëherë ai mund të kërkojë që edhe ky komitet të shprehë mendimin e vet.
2. Kur komiteti vlereson se një projekt që i është dërguar një komiteti tjetër është në kompetencën e tij, atëherë mund të kërkojë që ky projekt t'i kthehet atij dhe që ai të jep mendimin e tij lidhur me te.
3. Kur ka mosmarrëveshje në mes të komiteteve në lidhje me kompetencat e tyre atëherë, këto mosmarrëveshje zgjidhen në kuvend me anë të votimeve me shumicë votash.

**Neni 58**

Në mbledhjet e komiteteve mbahet procesverbali i shkurtër që firmoset nga kryesuesi i komitetit. Këto procesverbale u vëhen në dispozicion anëtarëve të komiteteve.

**Neni 59**

Në mbledhjet publike të komiteteve mund të prezantojnë edhe përfaqësuesit e shtypit dhe të mediave elektronike.

**Neni 60**

Anëtarët e komiteteve duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet të komiteteve. Kur një anëtar i komitetit mungon pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi, komiteti mund të vendos që në mbledhje të kuvendit të kërkojë zëvendësimin e tij me një anëtar tjetër.

**3. V o t i m i****Neni 61**

1. Përveç kur statuti dhe rregullorja e përcakton ndryshe, votimi në të gjitha mbledhjet e kuvendit dhe të komiteteve bëhet me ngritjen e dorës, përpos nëse në mbledhje vendoset që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë.

2. Kuvendi mund të deklarohet për formën e votimit kur ka mundësi të zgjedhjes.

**Neni 62**

Para votimit, secili nga anëtarët ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen, në mënyrë që të shihen emrat e të gjithë anëtarëve që kanë votuar dhe emrat e atyre që abstenojnë.

**Neni 63**

Secili nga anëtarët mund të kërkojë që në procesverbal të mbledhjes të shënohet se si ai/ajo ka votuar për çështjen e caktuar, ose nëse ai/ajo ka abstenuar.

**Neni 64**

1. Kur duhet të zgjedhet ose të emërohet ndonjë anëtar për ndonjë funksion apo pozitë në komunë dhe kur për këtë ekzistojnë dy ose më shumë propozime, emrat e të propozuarve shënohen në listë, sipas renditjes së alfabetit të mbiemrave të tyre.

2. Votimi bëhet ashtu që në fletëvotim shënohet me shenjën **X** afër emrit të kandidatit për të cilin kandidati dëshiron të votojë, duke hedhur fletëvotimin në kutinë e caktuar për votim.

3. Abstenimet duhet të regjistrohen nëse hedhet fletëvotimi i pa markuar në kuti.

**Neni 65**

Komisioni i votimit që zgjidhet nga kuvendi, pasi të kryhet votimi i numëron votat publikisht menjëherë në mbledhje, dhe i publikon rezultatet e votimit. Shërbimi administrativ i kuvendit duhet t'i mbajë fletëvotimet në vend të sigurtë më së paku 12 muaj.

**4. Sjelljet jo të mira****Neni 66**

Nëse kryesuesi i mbledhjes konsideron se ndonjëri prej anëtarëve nuk ka sjellje të mira në mbledhje, e që me dashje e pengon punën e mbledhjes atëherë, kryesuesi atij ia tërheq

vërejtjen, nëse sjelljet e tij edhe pas vërejtjes nuk ndryshojnë, atëherë, kryesuesi ndaj tij mund t'i marrë këto masa:

-të pranishmëve në mbledhje u propozon që ky anëtar të mos dëgjohet. Nëse miratohet propozimi i kryesuesit nga të pranishmit anëtarit, me sjellje jo të mirë i ndalohet diskutimi i mëtutjeshme në mbledhje.

-urdhëron anëtarin të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes përveç në rastet kur ka votime.

-propozon të shtyhet mbledhja për një orë ose për kohë më të gjatë.

#### **Neni 67**

Nëse pjesëtari i publikut prezent në mbledhje me dashje pengon punët në mbledhje, kryesuesi i mbledhjes atij/asaj do t'ia tërheqë vërejtjen. Nëse ai/ajo vazhdon ta pengojë mbledhjen kryesuesi mund t'i ndërmarr këto masa:

- e udhëzon pjesëtarin e publikut që të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga mbledhja.

- kërkon që personi të largohet nga mbledhja.

- mund të shtyjë mbajtjen e mbledhjes për një orë ose për një kohë më të gjatë.

#### **Neni 68**

Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim të madh në mbledhje, kryesuesi mund të kërkojë që të gjithë që prezantojnë në mbledhje ta lirojnë sallën dhe mund ta shtyjë mbledhjen për një orë ose për një kohë më të gjatë.

### **Shërbimi Administrativ i Kuvendit**

#### **Neni 69**

Shërbimi administrativ i kuvendit është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale administrative dhe teknike për nevojat e kuvendit.

### **5. Hyrja në fuqi**

#### **Neni 70**

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

#### **Neni 71**

Ditën e hyrjes së kësaj rregullore në fuqi shfuqizohet Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës së Rahovecit të datës 24. 03. 2003.

**01 Nr. 693**

**Data 15 Maj 2009**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Xhemali Haxhimustafa**